

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Foltorja e Ripërtërimitjes, Elbasan - Bianca Çopja: Partia Demokratike e kaloi oqeanin, tani duhet të jetë ur agani që përmbys korrupsionin
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919184/bianca-copja-partia-demokratike-e-kaloi-oqeanin-tan-i-duhet-te-jete-uragani-qe-permbys-korrupsionin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 16:49:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 16:43:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	01817cfbe836ac5c12b8992819d98842400e3fadae295f40804e907787aa7222
TEKSTI	0f4945f62b0a8145232f97cac392921ca9461c375fec8d49d562c5635c36012d
PAMJA	bba9a10e12cb4336f1996ec350dfd38ab49fb8de462794517daed56435e44608

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f8a40ae8e5e05de905b1e66732ef2d2cfc333af5f0f448cded166c4c0199536a
E MËPARSHMJA	d7c75df87424288bc28aaef4bacf371888caeda1d7b92751050f632b56575533
RRËNJA MERKLE	96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f8a40ae8e5e05de905b1e66732ef2d2cfc333af5f0f448cded166c4c0199536a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**


Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raportit ynë me të vërtetën!

LAJMI I FUNDIT**LIVE/ Foltorja e Ripërtëritjes me Kryetarin e PD-së, Sali Berisha, në Elbasan****më të lexuarat**


'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë



Akuzat ndaj shesheve të SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë




'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



Akuzat për shfeten e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin



Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës



Bianka Çopja: Partia Demokratike e kaloi oqeanin, tani duhet të jetë uragani që përmbys korrupsionin

18:43, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Në foltoren e ripërtëritjes së Partisë Demokratike në Elbasan, Bianca Çopja, kryekëshilltare bashkiake e opozitës në Bashkinë Elbasan, e vuri theksin te një PD më e hapur dhe më pranë qytetarëve. Ajo solli në vëmendje problematikat konkrete të qytetit, nga ndotja e ajrit, infrastruktura dhe uji i pijshëm, te punësimi dhe mundësitë për të rinjtë.

Çopja theksoi se ripërtëritja duhet të bashkojë eksperiencën e demokratëve ndër vite me energjinë dhe idetë e brezit të ri, duke e shtrirë aktivitetin politik në çdo lagje, fshat dhe familje të Elbasanit. "Partia Demokratike duhet të jetë një parti ku qytetari ndien se ka një zë", u shpreh ajo, duke e mbyllur fjalën me një mesazh të fortë politik për të ardhmen e opozitës.

Bianka Çopja: Përsëritetja e gjithëve. I nderuar kryetar i Partisë Demokratike, profesor doktor Sali Berisha, të dashur demokratë. Unë jam Bianca Çopja, një nga të rinjtë e Partisë Demokratike dhe pse e re në këtë parti, më janë besuar poste të rëndësishme falë vullnetit, punës dhe përkushtimit për të çuar përpara Partinë Demokratike dhe atë rrugëtim që nisi 36 vite më parë. Është një rrugëtim që ne të rinjtë duhet ta trashëgojmë brez pas brezi, se Partia Demokratike është një aset kombëtar, frymëzim i qëndrueshëm dhe i lirisë. Për mua Partia Demokratike duhet trashëguar brez pas brezi dhe mbi të gjitha ripërtëritja e Partisë Demokratike nuk është thjesht një ndryshim brenda një partie, është një mundësi për ta bërë Partinë Demokratike më të pranishme në jetën e përditshme të Elbasanit dhe më pranë qytetarëve, sepse ne e dimë shumë mirë çfarë e shqetëson sot Elbasanin dhe gjithë Shqipërinë. Na shqetëson ndotja e ajrit, një problem që është dokumentuar edhe në raporte të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Na shqetëson gjendja e rrugëve dhe trafikut, problematikat me ujin e pijshëm, kanalizimet dhe infrastruktura. Na shqetëson korrupsioni, arroganca e pushtetit, problematika të tjera që na shqetësojnë mes qytetit dhe fshatit, ende ka diferenca në shërbime dhe mundësi. Na shqetëson e ardhmja e të rinjve të Elbasanit, mundësitë për

punë, zivillimi dhe për të ndërtuar jetën këtu pa qenë të detyruar të largohen. Pikërisht këtu duhet të jetë dhe Partia Demokratike. Ne nuk jemi një parti elektorale, por një parti më pranë qytetarit, në lagje, në fshatra, në njësitë administrative, pranë familjeve dhe pranë çdo qytetari. Si një vajzë e re elbasanase, unë besoj se ripërtëritja duhet të sjellë më shumë energji, më shumë të rinj dhe më shumë mundësi për të kontribuar. Duhet të bashkojmë eksperiencën e personave të parë themelues, që kanë kontribuar ndër vite, me energjinë, idetë dhe guximin e një brezi të ri. Dua një Parti Demokratike që të jetë e hapur për të rinjtë, për gratë, për profesionistët, për sipërmarrësit dhe për çdo qytetar që ka diçka për t'i dhënë Elbasanit. Një Parti Demokratike që flet për ajrin që marrim frymë, për ujin që na mungon, për rrugët ku lëvizim, për fshatrat që kërkojnë shërbime, për familjet që kërkojnë më shumë mundësi dhe për të rinjtë që kërkojnë një arsye për të qëndruar këtu. Kjo është mënyra se si mund ta forcojmë Partinë Demokratike, duke forcuar lidhjen në qytetin. Dhe unë besoj tek kjo rrugë. Besoj se Elbasani ka njerëz, ka energji dhe ka potencial të madh për të kontribuar për shpëtimin e vendit. Dhe besoj se edhe ne duhet të ndryshojmë mënyrën si jemi pranë tyre. Duhet ta hapim Partinë Demokratike, ta ripërtërijmë me energji të re, të afrohem në çdo lagje, çdo njësi dhe çdo familje të Elbasanit. Dhe mbi të gjitha, ta bëjmë përsëri një parti ku qytetari ndien se ka një zë. Sepse Partia Demokratike ka qenë dhe është një alternativë. Këtu dua të sjell dhe unë eksperiencën time si një vajzë e re qytetari, t'i japim energji, punë, përkushtim dhe besim të Elbasani. Dhe dua ta mbyll me një mesazh. Partia Demokratike e kaloi oqeanin, edhe pse stuhia ishte shumë e fortë. Por të jeni të sigurt, Partia Demokratike do të jetë uragani që do të marrë përpara rilindjen e zezë të korrupsionit. Faleminderit doktor Berisha, faleminderit të gjithëve!

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Maliqi nuk është hartë për t'u vizatuar nga lart'/ Alolli: Para se të ndryshoni hartën, përgjigjuni qytetarëve



'Rama jepe dorëheqjen!' Protestuesit nisin marshimin drejt Kryeministrit në qendresën e 118-të



VIDEO/ Berisha: Do shtojmë të paktën 40 bashki, 'do t'i japim përgjigjen përfundimtare këtij regjimi'

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



VIDEO/ Berisha: 'Tiranë mediatiqe' fsheh Shqipërinë e varfër dhe emigracionin, 1.1 milion shqiptarë janë larguar



118 ditë rezistencë popullore – Skandalet e reja, protestuesit kërkojnë dorëheqjen e Ramës dhe qeverisë së tij



'Ngjyra blu, ngjyra e shpresës'/ Alizoti: Rrënja e mirë prodhon risi të mirë! PD ka nevojë për qëndrestarët dhe të rinjtë



VIDEO/ Berisha: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, kërkon ndërhyrje të menjëhershme



VIDEO-'Dyqanet plot, xhepat bosh'/ Berisha: Pensionistët nuk blejnë dot ilaçet, regjimi i Ramës po shkatërron Shqipërinë



'Të mos ketë derë të mbyllur për të rinjtë'/ Narazani: Ripërtëritja e PD ka nisur, Elbasani është dëshmia



VIDEO/ Berisha: Vezë mbi Padrinon në New York! Dënoj me forcë sharjet e Ramës ndaj diasporës

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.